



AKT THEMELIMI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“SELCOM” SH.P.K.

Neni 1

Midis te nenshkruarve:

- GENTIAN SULA, i biri i Astrit, lindur me date 29.07.1970 dhe banues ne Tirane, Rr. Ded Gjon Luli, Pall.7 katesh, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.
- ALTIN BUSHKA, i biri i Pellumbit, i dtl. 13.04.1975, lindur ne Vranisht, Devoll e banues ne Rr. Komuna e Parisit, Pall.101/17, Tirane, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Pasaporte Nr. Z 1353477.

arrihet marrveshja per formimin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “SELCOM” Shpk, e cila do te zhvillohet ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe normave qe vijojne.

Neni 2

Shoqeria ka statusin e personit juridik dhe vulen e saj. Selia e saj eshte ne adresen, Selite, Tirane, Shqiperi.

Neni 3

Marrdheniet qe lindin nga ky akt themelimi si dhe marrdheniet e saj me persona te trete fizike apo juridike shqiptare apo te huaj rregullohen sipas dispozitave te ketij Akti Themelimi, te Statutit perkates, te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 “Per Shoqerite Tregtare”, te Ligjit Nr.8618 date 14.06.2000 “Per Telekomunikacionet ne Republiken e Shqiperise” dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore qe rregullojne veprimtarine e subjekteve private.

Shoqeria pergjigjet vetem per pasurine e saj. Ajo nuk pergjigjet per detyrimet qe marrin Ortaket si persona fizik tej veprimtarise se Shoqerise apo tej kapitalit themeltar te saj. Po keshtu Ortaket nuk pergjigjen per detyrimet e Shoqerise tej kapitalit te tij themeltar ne kete shoqeri.



Neni 4

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht:

- Shërbime të telefonisë rurale;
- Shërbimin e ofrimit të internetit (ISP);
- Komunikim të dhënash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Komunikim të multimedias dhe ISDN, komunikim me teletëkst dhe videotëkst;
- Shërbime me vlerë të shtuar; si dhe çdo shërbim tjetër të telekomunikacionit që Shoqëria mund të ofrojë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Në përputhje me legjislacionin shqiptar, për të arritur qëllimet e përmendura, Shoqëria mund të:

- kryejë çdo transaksion lidhur me pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, gjithashtu edhe çdo aktivitet tregtimi, financiar, qiradhënieje apo hipotekimi, i cili mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm nga Administratori/Administratores me qëllim që të arrihet qëllimi i Shoqërisë, me kusht që këto aktivitete të mos kryhen në tejkalim të atyre të përmendura më sipër;
- kryejë aktivitete publikimi dhe reklamimi;
- nënshkruajë garanci të çfarëdo lloji, duke përfshirë garancitë e pagimit të kambialit;
- marrë, direkt apo indirekt, interesa në shoqëri të tjera, të cilat mund të kenë qëllim të njëjtë me atë të Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë.

Shoqëria mund të kryejë aktivitete të tjera të lidhura ose plotësuese me ato të parat dhe çdo aktivitet tjetër të nevojshëm ose të dobishëm për qëllimin shoqëror.

Neni 5

Veprimtaria e Shoqërisë, emertimi dhe selia e saj të përcaktuara në këtë Akt Themelimi nuk mund të ndryshojnë pa vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 6

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) leke të reja, i ndarë në 100 kuota njësi me nga 1.000 (njemijë) leke të reja secila. Çdo kuote njësi të jep të drejtën e një vote.

Kapitali themeltar nënshkruhet teresisisht dhe po ashtu është shlyer nga ortakët, sipas kuotave pjesëmarrëse si vijon:

- | | |
|-----------------|-----------------------------|
| 1. ALTIN BUSHKA | 35 % të kapitalit themeltar |
| 2. GENTIAN SULA | 65 % të kapitalit themeltar |



Neni 7

Jetegjatesia e Shoqerise eshte mbi 10 vjet, pervec ndonje zgjidhje tjeter te parakoheshme.

Neni 8

Fitimi i realizuar nga shoqeria pas zbritjes se detyrimeve ligjore dhe fondeve te percaktuara, merren nga Ortaket sipas raportit te kuotave qe ata kane dhe perdoret sipas interesave te tyre.

Neni 9

Organet e Shoqerise jane:

- Asamblee e Ortakeve
- Administratori

Asamblee e Ortakeve eshte organi me i larte drejtues i Shoqerise. Ortaket mund te perfaqesohen ne mbledhje vetem sipas ligjit, nga ortake te tjere ose nga persona te besimit me prokure te rregullt te firmosur.

Neni 10

Firma shoqerore dhe perfaqesimi i Shoqerise persa i perket te treteve dhe ne gjykim i takon Administratorit.

Administrator i Shoqerise emerohet z. ALTIN BUSHKA.

Neni 11

Ortaket jane te detyruar te ruajne karakterin e rezervuar te dokumentacionit, te informacioneve e te eksperiencas se shkembyer ose te realizimeve te Shoqerise dhe te perdorin te gjitha mjetet e nevojshme per te mos perhapur edhe pjeserisht keto informacione.

Neni 12

Heqja dore nga kuota e vet ose transferimi mund te behet nga ortaket siç eshte parashikuar ne statut dhe legjislacioni ne fuqi.



Neni 13

Çdo mosmarrveshje, qe mund te linde midis Shoqerise dhe Ortakeve do te zgjidhet sipas Legjislacionit Shqiptar. Organi kompetent per zgjidhjen e mosmarrveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 14

Persa nuk parashikohet ne kete Akt Themelimi, do te aplikohen Nenet e Statutit te Shoqerise dhe dispozitat e Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

Neni 15

Ky Akt Themelimi, perbehet nga 15 nene dhe u redaktua ne kater ekzemplare, ne gjuhen shqipe.

ORTAKET

GENTIAN SULA

ALTIN BUSHKA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 413 Regj.

Nr. 368 Kol.

VERTETIM

Ne Tirane sot me date/2/04/2006(dymije e gjashte) para meje noterit u paraqiten personalisht, GENTIAN SULA, ALTIN BUSHKA te gjithë madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova nga leternjoftimet e tyre personale, te cilet me deklaruan se kane perpiluar nje statut jashte kesaj zyre, te cilen e firmosen para meje dhe une noterit e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER

NOTER
ARTAN TRESKA
RR. BASHAM CURRI
TEL. 0582140355.

